

KËSHILLI I ADMINISTRIMIT
“OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES” SH.A.
NUIS L81530018E

VENDIM

Nr. 6, datë 30.12.2019

“Për emërimin e Administratorit të Shoqërisë”

Në mbështetje të nenit 154/f të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neneve 15, 16 dhe 18 të Statutit të shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” Sh.A, Këshilli i Administrimit i shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” Sh.A, në mbledhjen e datës 20.12.2019,

VENDOSI:

1. Z. Petraq Lika emërohet Administrator i Shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” Sh.A.
2. Marrëdhëniet e punës së Administratorit me Shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” Sh.A., fillojnë më datë 31.12.2019.
3. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” Sh.A., për ndjekjen e procedurave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Përparim NEBIAJ



ANËTAR
Ceno KLOSI



ANËTAR
Dorian BABA



Sekretare – Mirela MUSTAFA



KËSHILLI I ADMINISTRIMIT
“OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES” SH.A.
NUIS L81530018E

VENDIM

Nr. 5, datë 30.12.2019

“Për lirim nga detyra të Administratorit të Shoqërisë”


Në mbështetje të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neneve 15, 16 dhe 18 të Statutit të shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” Sh.A, Këshilli i Administrimit i shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” Sh.A, pasi shqyrtoi kërkesën për dorëheqje të paraqitur nga Administratori i shoqërisë, me shkresën Nr ~~Ext19~~ Prot, datë 27.12.2019

VENDOSI:

1. Z. Marlon Druga lirohet nga detyra e Administratorit të Shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” Sh.A, me dorëheqjen e tij.
2. Në zbatim të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar, të bëhen reflektimet përkatëse në regjistrin tregtar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Përparim NEBIAJ



ANËTAR
Ceno KLOSI



ANËTAR
Dorian BABA



Sekretare – Mirela MUSTAFA



“OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE” SH.A

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË

AKSIONARI I VETËM

VENDIM

Nr. 6 datë 20.12.2019

“Për emërim të audituesve ligjorë”

Në mbështetje të nenit 135/ç të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, të ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, të nenit 12.3/d të Statutit të shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” Sh.A., për të kontrolluar dhe çertifikuar llogaritë vjetore për vitin 2019, Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” Sh.A, në mbledhjen e datës 20.12.2019,

VENDOSI:

1. Caktimin si auditues ligjorë, për të kontrolluar dhe çertifikuar llogaritë vjetore për vitin 2019 të shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” Sh.A, të ekspertëve:
 - Ilia ÇEÇE;
 - Ilda EKONOMI.
2. Shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” SH.A, para fillimit të punës, të nëshkruajë një kontratë me audituesit ligjorë për punën që do të kryhet, me përshkrimin e rubrikave e verifikimeve, kontrollove, raportimeve etj, për përmbushjen e misionit, orëve të punës të parashikuara si dhe honorarin gjithsej.
3. Përveç raportit standard të auditimit, audituesit ligjorë të shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” Sh.A duhet të dorëzojnë në “OSHEE” Sh.A, relacionin shpjegues për të gjitha zërat e bilancit si dhe sugjerimet e tyre për shoqëritë në vështirësi financiare.
4. Ngarkohet Këshilli i Administrimit dhe Administratori i Shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” Sh.A. për zbatimin e këtij vendimi dhe regjistrimin e tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME
AKSIONARI I VETËM
ADMINISTRATORI I “OSHEE” SH.A
Adrian ÇELA

OSHEE, sh.a.

Protokoli
Nr. 001